

Kosova më ka dhënë një leksion të mirë

Aktori amerikan Doug Barron, i cili luan një ndër rolet kryesore në filmin "Anatema" të Agim Sopit, është shprehur shumë i kënaqur për punën me ekipin kosovar të filmit. Ai i quan kosovarët miq të vërtetë

ARDIAN JASIQI

"Lajm": Si keni rënë në kontakt me regjisorin Agim Sopi?

Barron: Jemi njohur para shtatë vjetësh. Gjatë luftës na humbën kontaktet. Më pas, Sopi më thirri dhe, të them të drejtën, isha me të vërtetë shumë befasuar. Ai ma dërgoi skenarin e filmit në shqip, por pasi nuk e kuptova, ma dërgoi edhe në anglisht.

"Lajm": Ç'menduat kur e lexuat për herë të parë skenarin?

Barron: Rrëfimi ishte shumë interesant. Në anglisht, skenari thuhet i tjeri ishte i shkruar në dialektin britanik. Unë punova që skenari "të flisë" sa më shumë në dialektin amerikan. Mandej filluam të punojmë dhe të bëjmë disa ndryshime për karakterin e Lorës (Blerta Sylja). Në këtë aspekt na ndihmoi edhe Sevdie Kastrati. Bashkëpunimi ishte i shkëlqyer dhe

Blerta e adaptoi rolin shumë mirë.

"Lajm": Cila pjesë e skenarit ju ka pëlqyer më së shumti?

Barron: Ka shumë pjesë të skenarit që më kanë pëlqyer. Mendoj se është bërë punë shumë e mirë. Më kanë pëlqyer skenat në të cilat luan aktori Enveri Petrovci, rolin e një serbi. Aktrimi i tij ishte shumë i mirë. Ishin skena shumë origjinale. Po ashtu më ka pëlqyer udhëtimi me makinë, së bashku me Lumnie Sopin, ngase, përveç skenave të bukura që kemi xhiruar, kemi vizituar edhe vende të bukura, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri.

"Lajm": Çfarë është dallimi ndërmjet punës rreth filmit që xhirohet në Kosovë dhe atij që xhirohet në SHBA?

Barron: Dallime ka shumë. Por, ajo që duhet të them është se Agim

Sopi është njeri i pasionuar pas regjisë. Vlerësoj shumë diskutimin që kemi bërë për filmin, po ashtu edhe miqësinë me njëri-tjetrin, gjë që në SHBA nuk ekziston. Po ashtu, vlerësoj punën e ekipit që, me gjithë buxhetin e vogël, punoi me shumë pasion për ta realizuar projektin. Në SHBA filmi është më i shtrenjtë dhe, normalisht, kushtet për punë janë të mira. Puna në Kosovë më ka dhënë një leksion të mirë. Më ka mësuar si të jem edhe një shok i mirë për kolegun.


"Lajm": Çfarë ishte bashkëpunimi me aktorët kosovarë?

Barron: Bashkëpunimi ishte shumë i mirë. Gjatë xhirimeve diskutonim probleme të ndryshme për filmin, me aktorin Enver Petrovci. Aktorët kosovarë janë të përgatitur shumë mirë fizikisht për të luajtur role. Ka pasur edhe oficerë të ushtrisë shqiptare (gjatë xhirimeve në Shqipëri),

Kush është Doug Barron?

Doug Barron ka luajtur në një mori filmash në SHBA. Një ndër filmat e parë të tij është "House of Woman". Ka luajtur më shumë në filma televizivë, por edhe artistikë. Shquhet për rolet në "Ana & Ema", "Just Visiting", "The Yards", "The Swedish", etj. Karrierën e aktorit e nisi në vitin 1980, ndërsa është shpërblyer disa herë për punën e tij.

të cilët i kanë kryer detyrat e tyre për mrekulli. Edhe me Lumnie Sopin bashkëpunimi ishte i mirë. Ndërkaq, me Blerta Sylën kemi punuar më së shumti, pasi ajo e luan rolin e një amerikaneje dhe unë dëshiroja që theksi i saj të ishte sa më amerikan.



"Anatema" u dha premierë

Është cilësuar si film i guximshëm, i lehtë për t'u kuptuar dhe i realizuar mirë, filmi "Anatema", premiera e të cilit është shfaqur të hënën mbrëma, në Kinemanë ABC të Prishtinës. Sopi tha se filmi është i kosovarëve, pasi që është realizuar nga kosovarët. "Kjo tregon se në Kosovë ka njerëz që dinë të bëjnë film, por nuk ka mjete financiare për këtë".

Sipas Sopit, në film ka përshkruar edhe ngjarje të luftës, të cilat vetë i ka përjetuar. Ndërkaq aktorja Lumnie Sopi tha se rolin e saj, edhe pse kompleks, ia ka dalë ta realizojë si duhet. Aktori Doug Barron u shpreh i nderuar që është pjesë e filmit. Për borxhet, të cilat Sopi ua ka ndonjë aktori, do të përkujdeset Sali Limani, bashkëproducent i filmit.

"Anatema" ka kushtuar rreth 700 000 euro, 300.000 nga të cilat janë dhënë nga Ministria e Kulturës. Film do të shfaqet edhe në Pejë, Gjilan, Deçan, Prizren dhe vende të tjera të Kosovës. (a. jasiqi)



► Kuadër nga filmi

► Doug Barron